



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 871/1 prot.
2023

Tiranë, më 31. 07.

V E N D I M

Nr. 148, datë 31. 07. 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 149 regj, datë 25.07.2023, të paraqitur nga subjekti ankues, S. T., në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve Tiranë-Kamëz-Tiranë¹.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, S. T., në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon ndër të tjera se, i përket kategorisë së të verbërve të grupit të parë prej datës 01.10.2022 dhe që nga kjo periudhë, siç ka bërë edhe më parë, ai ka paguar biletën e transportit urban. Nga data 04.07.2023, ankuesi thekson se është antarësuar në Shoqatën “Shpresë për të Verbërit” dhe është informuar se, mbështetur në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar, të verbërit dhe shoqëruesit e tyre kanë të drejtë të udhëtojnë falas në shërbimin urban dhe 50% të vlerës në atë Interurban. Nga data e antarësimit në Shoqatën “Shpresë për të Verbërit”, ankuesi referon se ka përdorur librezën e shoqatës për të përfituar nga lehtësirat e parashikuara në ligjin e sipërcituar. Sipas tij, në të gjitha linjat e transportit publik të qytetit të Tiranës nuk ka hasur pengesa, pasi i është njohur librezë e Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, ndërsa vetëm në linjën e Kamzës nuk i njihet kjo e drejtë, duke i thënë që “*njohim vetem librezën e invalidëve të punës*”. Në këto kushte është detyruar të paguajë biletë e transportit të plotë.

¹ Mbështetur në ankesat e trajtuara më parë nga KMD, me Nr. 206, datë 23.12.2023, është konstatuar se linja e transportit të udhëtarëve Tiranë-Kamëz-Tiranë, mbulohet nga shoqëria e transportit “Shpresa AI”.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese, si dhe eliminimin e pasojave që sjell kjo formë diskriminimi.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikohet: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”

Sa i përket pretendimeve të sipërcituara në ankesën e paraqitur, Komisioneri evidenton faktin se ankuesi ka parashtruar në ankesën e tij, se linja e transportit të udhëtarëve Tiranë-Kamëz-Tiranë, e ofruar nga Shoqëria “Shpresa AI”, e diskriminon për shkak të aftësisë së kufizuar pasi nuk i njeht dokumentin e Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”. Sipas tij, kjo shoqëri nuk e quan të ligjshëm këtë dokument, duke bërë diferencime krahasuar me nga dokumentin që lëshon Shoqata e Invalidëve të Punës, lidhur me invalidët e punës.

Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, Komisioneri me vendimet e mëparshme Nr. 53, datë 06.04.2023 dhe Nr. 76, datë 22.05.2023, ka konstatuar mosdiskriminimin e anëtarëve të Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, si rezultat i mosnjohjes dokumentit zyrtar të identifikimit të paaftësisë, lëshuar prej tyre, nga ana e shoqërive të transportit publik urban dhe interurban, pasi ka gjykuar se:

Këto dy kategori personash me aftësi të kufizuar: ato me status të verbëri dhe ato me status invalid pune, përfitojnë lehtësira lidhur me transportin urban, sipas parashikimeve ligjore përkatëse që rregullohen në ligjin specifik të secilës kategori.

Kështu, ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, në nenin 4, të tij ka përcaktuar se:

“Invalidët paisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës në bazë të KMCAPI”.

Pra, bazuar në ligjin sipërcituar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e invalidit të punës me dëshminë zyrtare të identifikimit është Shoqata e Invalidëve të Punës.

Ndërsa, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e

personave të verbër me dëshminë zyrtare të identifikimit, librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë, është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Për rrjedhojë, në situatën e analizuar më sipër (parashikimet ligjore për legjitimitimin e autoriteteve përgjegjëse kompetente për lëshimin e dokumentit zyrtar të identifikimit të paaftësisë) rezulton qartë që Shoqata Kombëtare "Shpresë për të verbërit", nuk ndodhet në kushte të njëjta me Shoqatën e Invalidëve të Punës, dhe për rrjedhojë, nuk mund të krahasohet me të, dhe në këtë kontekst, Komisioneri ka vlerësuar se nuk mund të pretendohet për trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm krahasimisht me të.

Sakaq, Komisioneri vlerëson se, për të njëjtën çështje të bërë objekt shqyrtimi nga ankuesi nëpërmjet paraqitjes së kësaj ankese, është marrë një vendim i mëparshëm. Pra, nuk jemi në kushtet kur kemi të dhëna të reja, në mënyrë që të mundësohet marrja në shqyrtim e pretendimeve të bëra nga ankuesi në ankesën objekt shqyrtimi. Çështja e parashtruar që përbën objektin e kësaj ankese është e njëjtë me çështjet e marra më parë në shqyrtim nga ana e Komisionerit dhe për të cilat janë marrë një vendimet e mëparshme, Nr. 53, datë 06.04.2023 dhe Nr. 76, datë 22.05.2023, ku është konstatuar mosdiskriminimi i subjekteve ankuese, anëtarë të Shoqatës Kombëtare "Shpresë për të Verbërit", në fushën e të mira dhe shërbimeve, nga ana e shoqërive të transportit publik urban dhe interurban, për shkak të aftësisë së kufizuar. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se për ligjen kërkesat e nenit 33/4/c, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar dhe ankesa e paraqitur nuk mund të pranohet pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma "c"³ të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi S. T. kundër shoqërisë që ofron shërbimin e transportit të udhëtarëve në linjën Tiranë-Kamëz-Tiranë, Shpresa Al, nuk

³ Ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, parashikon se: "4. **Ankesa nuk pranohet nëse:** a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; **c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;** ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese".

mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/c dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, S. T., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)